

Bénédict



Apliko tani
Gjuhë - Tregëti - Mjekësi - Informatik
Manaxhim - Studime Bachelor/Master

Na ndiqni:



Shqip | Deutsch | Français

E ENJTE
8 Dhjetor 2022

Shkarko App..

albinfo.ch

AKTUALITETI I SHQIPTARËVE NË ZVICËR



WHO'S WHO?
Sylë Peci

> Të gjitha

E-DIASPORA

JETA NË ZVICËR

CH-BALLKANI

ALBINFO.TV

KULTURA

SPORT

FINANCA

BIZNESET

SHOQATAT

KALENDARI

TË TJERA



SEARCH...



Made in Kosova

„Swissbau“: Prodhimet e drurit nga Kosova, të lira dhe cilësore

E mërkurë, 13 Janar 2016 - 14:00

Sevdail Tahiri

Share 435

Tweet 0

Të tjera nga Made in Kosova



Numri më i ri i magazinës albinfo.ch i kushtohet industrisë kosovare të drurit

Përrurohet depoja e madhe ushqimore me produkte “Made



Reklamë

Industria e përpunimit të drurit në Kosovë shihet si një nga industritë me potencial të madh për eksport, për shkak të zhvillimit të saj të hovshëm gjatë viteve të fundit.

Suksesi i tyre po shihet në njërin prej panairove më të mëdha evropiane „Swissbau“, që po mbahet në Bazel të Zvicrës.



„Elnor“, „Lesna“ dhe „Shehu“ nga Kosova janë kompani të njohura me cilësi të prodhimit të dyerve, dritareve, shkallëve prej druri dhe mobiljeve të tjera, të cilat po konkurrojnë me produktet e 19 vendeve të tjera ekspozuese të panairit.

Krahas kualitetit, prodhuesit kosovarë dallohen edhe me raportin ideal çmim-rezultat, pasi që ata e kanë mundësinë të punojnë në kushtet lokale të një kostoje të ulët.

Gjeografikisht Kosova është në një pozitë të volitshme për tregti me vendet fqinje, por po ashtu edhe me Evropën Qendrore dhe Perëndimore.

„Elnor“ është një kompani kosovare që tashmë ka depërtuar në tregun zviceran që nga viti 2011, madje është edhe e regjistruar në listën e frimave zvicerane me emrin „Elnor Swiss“.



in Kosova” në Zvicër

‘Shija e Kosovës Online’ sjell produktet e veçanta të bizneseve vendore

Rrugëtimi i kompanisë kosovare Ciao Berto – nga zeroja drejt tregut evropian!



Albinfo.TV

Dua Lipa nuk ka shtetësi të Kosovës

Shqipëria
Për nder të 28 Nëntorit, Dua Lipa do të elektrizojë Tiranën

Kosova
Dua Lipa merr nënshtetësinë shqiptare

Muzikë
VIDEO: Dua Lipa flet për rëndësinë e veprës së Ismail Kadarese në jetën e saj

> Të gjitha

Reklamë

© 2016 ALBINFO
Sheqer Ukaj – Elnor

Drejtori i kësaj kompanie, Sheqer Ukaj, thotë për albinfo.ch se tashmë kanë aktivitet ekonomik dhe tregtar në Zvicër.

„Nga ky panair presim zgjerimin e aktivitetit tonë, përfitimin e blerësve të rinj dhe natyrisht zgjerimin e tregut“, tha Ukaj, duke u shprehur „entuziast“ me vendin që i është rezervuar kompanive kosovare në Swissbau.

„Ne jemi të kënaqur me vendin e caktuar për standin e firmave kosovare, duke e pasur parasysh koston e lartë të pjesëmarrjes në panair. Për bizneset nga Kosova është e lartë kostoja e pjesëmarrjes, por duke falënderuar donatorët është bërë e mundur prania jonë në Bazel dhe konsiderojmë që do të kemi sukses në „Swissbau“, thotë Ukaj.

Ndërsa sa i përket kualitetit me konkurrencën në panair, afaristi nga Kosova tha të jenë afër nivelit të tyre, por jo t'i kenë kaluar.

„Të jesh i barabartë në treg do të thotë shumë dhe duhet kërkuar mundësitë për të kapur hapin“, thotë në këtë bashkëbisedim me albinfo.ch drejtori i „Elnor“ nga Kosova.



© 2016 ALBINFO
Bekim Dëshishku – Lesna

Edhe kompania tjetër nga Prishtina „Lesna“ nuk është hera e parë që promovon prodhimet e saj jashtë Kosovës, ndërsa pritjet për menaxherët e saj janë të mëdha nga panairi „Swissbau“ në Bazel.

„Sa i përket kualitetit me dritare, nuk kemi asnjë dallim të produkteve që prodhohen në Kosovë në bazë të standardeve të kërkuara në Evropë. Dallimi është vetëm se prodhohen në Prishtinë. Derisa kostoja e prodhimit është më e lirë, edhe produkti është dy herë më i lirë. Por, ne edhe fitojmë më pak në krahasim me prodhuesit në Evropë“, tha Bekim Dëshishku, përfaqësues i kompanisë „Lesna“.



MË TË SHIKUARAT TË FUNDIT



Vjenë, Kurti: Nuk mjafton „perspektiva në BE“, duhet një proces i përshpejtuar



Arbër Bullakaj mund të bëhet deputet federal, pas tërheqjes së Rechtsteiner-it



Shqipërisë, 80 mln euro nga 1 mld eurot e BE-së



Disa pensionistë mund të mbeten pa para gjatë jetës së tyre në Zvicër



© 2016 ALBINFO

Kreshnik Shehu – “Shehu”

Edhe nga kompania tjetër „Shehu” që vjen nga Kosova në Bazël thonë se produktet e tyre janë të veçanta, ngase të gjitha punohen me dru masiv dhe kanë një trajtim të veçantë në prerje dhe lyerje.

„Për këtë nevojitet më shumë orë pune dhe me faktin se fuqia punëtore është më e lirë në Kosovë, direkt jemi konkurrent për shkak të çmimit. Dhe, kjo na ka shtyrë të jemi të pranishëm në Zvicër”, thotë për albinfo.ch përfaqësuesi i kompanisë „Shehu”, që bën prodhimin e shkallëve dhe dyerve të hyrjes.


Kjo kompani tashmë ka depërtuar në tregjet e Gjermanisë, Suedisë dhe së fundi edhe në Zvicër.

Pjesëmarrja e tri kompanive të Kosovës në panairin “Swissbau” është mundësuar nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), EMPOWER Sektori Privat i USAID-it dhe PPSE-Swisscontact, me mbështetje edhe nga Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës.

„Me financim të Zyrës zvicerane për zhvillim në Kosovë, bashkë me USAID-in dhe Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) po përkrahim Shoqatën e Përpunuesve të Drurit të Kosovës që të jetë e pranishme me tre përpunues në „Swissbau” në Bazël, për të krijuar lidhje biznesi me kompani të tjera në Zvicër”, thotë Edona Kurtolli nga Swisscontact – Prishtinë.

Këto kompani kosovare, krahas kualitetit të produkteve, i kanë çmimet përgjysmë më të lira, që i bën konkurrentë me firmat evropiane.

„Qëllimi i gjithë këtij projekti është hapja e vendeve të reja të punës në Kosovë. Gjenerimi i të ardhurave bëhet përmes shitjeve të produkteve, sidomos përmes eksportit. Në këtë mënyrë nëse ndodh të lidhen kontrata të reja me kompani zvicerane, automatikisht do të gjenerohet edhe hapja e vendeve të reja të punës në Kosovë”, thotë Kurtolli.




Edhe Rexhep Iljazi nga USAID-i tha se e vetmja mënyrë për të depërtuar në tregun zviceran është promovimi në kontinuitet i produkteve kosovare në "Swissbau" në Bazel.

„Swissbau 2016“ mbetet i hapur deri më 16 janar në Bazel. 1100 ekspozues nga 19 vende kanë prezantuar prodhimet e tyre në 140.000 metra katrorë. Organizatorët presin deri mbi 100 mijë vizitorë.

Tweet 0 Share 435

LAJME INTERESANTE NGA INTERNETI



E-DIASPORA

Die Stunde der Ersatzspieler

St. Galler Ständerersatzwahl schlägt auf den Nationalrat durch - das sind die wahrscheinlichsten Wechsel.

Regula Wink

Es gibt ein vier Frauen. Und ihre Ambitionen. Um Barbara Cysi, Esther Friedli, Susanne Vinomo-Staufacher, Franziska Bruner. Sie stehen in den Kandidatenspielen. Sie kämpfen um den frei werdenden St. Galler Ständerersatz. Sie werden in den nächsten Wahlen gewählt werden - jedes Voraus, jeder Auftritt, jedes Lächeln, jedes Interview.

Dann gibt es da noch eine Gruppe von Politikerinnen und Politikern. Ihre Worte werden nicht auf die Waagschale gelegt. Ihre Auftritte nicht minutensorgfältig verfolgt. Ihre Kleidung ist kein Thema - auch nicht. Das könnte sich bald ändern. Denn sich eine der vier Kandidatinnen durchschlägt, das auf den Nationalrat durch. Dann kommt es dort zu einem Wechsel, denn alle vier sind Nationalrätinnen. Das sind die Personen in der Poliposition.

SVP Der Fall ist klar

«Der Generationenwechsel ist vorangetrieben: So schrieb diese Zeitung im Sommer. Dies, nachdem die beiden SP-Nationalrätinnen Claudia Föllmi und Barbara Cysi bekanntgegeben hatten, bei den Wahlen im nächsten Herbst erneut zu kandidieren. Die Halbweitspieler politischer Einrückung sind



ARBËR BULLAKAJ MUND TË BËHET DEPUTET FEDERAL, PAS TËRHEQJES SË RECHTSTEINER-IT

Në zgjedhjet e fundit federale, ato të vitit 2019, ai arriti vendin e parë zëvendësues. Nëse...

“EMPERIO AG” ju
nndihmon t'i shitni objektet
para se ato të ndërtohen

Vdekja e mërgimtarit nga
Norvegjia në burgun e
Serbisë ngjall dyshime

Shqiptarja, një nga
fitueset e Standout
Woman Award 2022

Shpëtim Bajrami
doktoron në afat rekord
në Gjermani

JETA NË ZVICËR

Die Stunde der Ersatzspieler

St. Galler Ständerersatzwahl schlägt auf den Nationalrat durch - das sind die wahrscheinlichsten Wechsel.

Regula Wink

Es geht um vier Frauen. Und ihre Ambitionen. Um Barbara Cysti, Esther Friedli, Susanne Vincenti-Stauffacher, Franziska Bruner. Sie stehen in den Ständerwahlen. Sie kämpfen um den frei werdenden St. Galler Ständerersatzsitz. Sie werden in den nächsten Wochen genannt werden - jedes Wort, jeder Auftritt, jedes Lächeln, jedes Stirnrunzeln.

Denn gibt es da noch eine Gruppe von Politikern und Politikerinnen. Ihre Wähler werden nicht auf die Waagschale gelegt, ihre Auftritte nicht besonders verfolgt. Ihre Kleidung ist kein Thema - noch nicht. Das könnte sich bald ändern. Denn sich eine der vier Kandidatinnen durch, schlägt das auf den Nationalrat durch. Dann kommt es denn zu einem Wechsel, denn alle vier sind Nationalrätinnen. Das sind die Personen in der Reihenfolge.

SP: Der Fall ist klar

«Der Generationenwechsel ist vorangetrieben. In der letzten Zeitung im Sommer. Dies, nachdem die beiden SP-Nationalrätinnen Claudia Friedli und Barbara Cysti bekanntgegeben hatten, bei den Wahlen im nächsten Herbst erneut zu kandidieren. Der Halbwertzeit politischer Einschätzungen ist



ARBËR BULLAKAJ MUND TË BËHET DEPUTET FEDERAL, PAS TËRHEQJES SË RECHTSTEINER-IT

Në zgjedhjet e fundit federale, ato të vitit 2019, ai arriti vendin e parë zëvendësues. Nëse...



Disa pensionistë mund të
mbeten pa para gjatë
jetës së tyre në Zvicër

Zvicër: Nga 25,000
persona të kualifikuar,
vetëm 10% kanë aplikuar
për natyralizim të
lehtësuar

Inflacioni në Zvicër në
vitin 2023 pritet të mbetet
mbi kufij

Alain Berset, president i
Zvicrës nga 1 janari deri
më 31 dhjetor 2023

Jeta në Zvicër

Jeta në Gjermani

Jeta në Austri

E-Diaspora

CH-Ballkani

AT Balkani

Albinfo.tv

Kalendari

Sport

Bizneset

Shoqata

Dosjet

albinfo.ch

Copyright © 2018 albinfo.ch. All Rights Reserved.

Zhvilluar nga:

Impressum/Kontakt

Rreth nesh

Karta

Politika e Privatësisë

Kushtet e Përdorimit

Përdorimi i shkrimeve, fotografive si dhe materialeve të kësaj platforme mund të bëhet vetëm duke e përmendur burimin albinfo.ch. Cdo shfrytëzim dhe riprodhim i tyre pa lejen e albinfo.ch është i ndaluar dhe përbën shkelje e të drejtave autoriale. Redaksia e mban të drejtën për mosbotimin dhe moskthimin e dorëshkrimeve, fotografive apo materialeve të tjera të dërguara.

BASHKËPUNËTORËT